



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:075920

Datë: 29.09.2023

Numri i dokumentit: 04733908

P.nr.1097/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit B.S. nga Fushë Kosova, i akuzuar për veprën penale Rrezikim i trafikut publik neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/IL.nr.157/2021 të datës 27.004.2021, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 21.09.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi, i akuzuari B.S. me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Fatlume Korça Sekiraqa dhe i dëmtuari F.Q. me datë 21.09.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.09.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.S.i biri i H. dhe nëna H. e gjinisë M. i lindur me ..., në H. me vendbanim në Fshatin H. – F.K. me numër personal ... të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 04.12.2020, rreth orës 12:40, në rrugën nacionale P.P. saktësisht në fshatin V. –Komuna e F.K., i pandehuri duke vepruar në kundërshtim me nenin 120 par 1 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë në atë mënyrë që, derisa ishte duke vozitur nga drejtimi P.-P. në shiritin e majtë qarkullues me veturën e tipit ... ngjyrë e .. dhe me targa ... me të arritur në fshatin V. derisa automjeti që ishte para tij i tipit .. ngjyrë e .. me targa ... të cilin e drejtonte S.B. ndalet para vendkalimit për këmbësor, për shkak të mos mbajtjes së distancës me veturën përpara dhe në pamundësi të frenimit me kohe, e godet veturën përpara me ç ‘rast shkaktohet dëm material në të dy veturat si dhe lëndime trupore të lehta pëson vetë i pandehuri dhe lëndime të rënda trupor pëson pasagjeri F.Q.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 23, 38, 39, 46, 47, 48, 69, 70, 71, 72 dhe 370 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- I.** Për veprën penale Rrezikim i trafikut publik neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së, të akuzuarit B.S. Gjykata i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën verifikuese prej një (1) viti i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.
- II.** Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- III.** Pala e dëmtuar F.Q. për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.157/2021 të datës 27.004.2021, ndaj të akuzuarit B.S. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.09.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Nazmi Krasniqi, të akuzuarit B.S. me mbrojtësen e tij sipas detyrës zyrtare av. Fatlume Korça Sekiraqa, ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Rrezikim i trafikut publik neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të KPRK-së, i vjen keq për veprën penale të shkaktuar pasi që e njëjta është shkaktuar nga pakujdesia.

Pas deklarimit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si në aktakuzë, dhe se i propozon Gjykata që me rastin e përcaktimit të dënimit të merr si rrethane lehtësuese pranimin e fajësisë, po ashtu edhe mbrojtësja e të akuzuarit deklaroi se pranimi i fajësisë është bërë në konsultim me mbrojtjen e ka kuptuar benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ndihet keq për veprën penale të shkaktuar dhe se është penduar, këtë vepër e ka kryer nga pakujdesia dhe ka premtuar se do të jetë më i kujdesshëm në të ardhmen, i propozon Gjykatës të pranojë pranimin e fajësisë dhe të shqiptojë dënim sa më të butë. I dëmtuari është pajtuar me pranimin e fajësisë së të akuzuarit, pasi që rasti ka ndodhur aty për aty dhe nuk kam interes për ndjekjen e çështjes.

Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë për të cilat është njoftuar nga

Gjykata, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarinimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë ne këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarinimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Kallëzimi penal me numër 2020-TR-381, i datës 04.12.2020; Procesverbali mbi intervistimin e të dyshuarit i datës 08.12.2020 dhënë në Stacionin Policor në Fushë Kosovë; Konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit H. I. inxh, i datës 22-23.04.2023; Akt ekspertimi mjeko-ligjor lidhur me lëndimet trupore nga Eksperti Dr. Valon Hyseni, i datës 28.03.2021, si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit B.S. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Rrezikim i trafikut publik neni 370 par 8 lidhur me par 6 e lidhur me par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me pakujdesi, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë ne konflikt me ligjin. Gjithashtu i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer, po ashtu i njëjtë ka vepruar me pakujdesi. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, rrethana posaçërisht rënduese Gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 48 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Gjykata në kuptim të nenit 462 par. 2 të KPPRK-së, palën e dëmtuar e udhëzoi ne kontest civil për realizimin e kërkesës se saj pasurore juridike.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 te KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.1097/21 më datë 29.09.2023

Bashkëpunëtori Profesional

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Albrim Kastrati

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.